



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**BASHKIA MALLAKASTËR**  
**KRYETARI**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Ballsh, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2022

Lënda: **Formulari i Njoftimit të Fituesit**

**AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK - TIRANË**  
(për publikim në SPE dhe buletinin e njoftimeve publike)

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**  
**BASHKIA MALLAKASTËR**

Data 13.06.2022

Drejtuar: **“ELMAZAJ KONSTRUKSION” shpk**, me NIPT L33229401T, me adresë PORTËZ,  
Fier, zona kadastrale 3031, nr.Pasurie 307/39

\* \* \*

Procedura e prokurimit: **“E hapur”**

Numri i referencës së procedurës: **REF-27300-05-04-2022**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Blerje materiale të ndryshme, çakull, stabilizant dhe rërë bituminoze, për mirëmbajtje rrugësh”**, me fond limit **31,666,273** (tridhjetë e njëmilion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtëmijë e dyqind e shtatëdhjetë e tre) **Lekë pa TVSH**

Publikime të mëparshme: Buletini i Njoftimeve Publike nr.59, datë 9 Maj 2022

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

**Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:**

- 1. Operatori Ekonomik “SHKELQIMI 07” shpk**, me NIPT K68121808W, ka paraqitur ofertën ekonomike në shumën prej **27,690,284** (njëzetë e shtatëmilion e gjashtëqind e nëntëdhjetëmijë e dyqind e tetëdhjetë e katër) **lekë pa TVSH.**
- 2. Operatori Ekonomik “ARDMIR” shpk**, me NIPT K82509006P, ka paraqitur ofertën ekonomike në shumën prej **29,970,387** (njëzetë e nëntëmilion e nëntëqind e shtatëdhjetëmijë e treqind e tetëdhjetë e shtatë) **lekë pa TVSH.**
- 3. Operatori Ekonomik “ELMAZAJ KONSTRUKSION” shpk**, me NIPT L33229401T, ka paraqitur ofertën ekonomike në shumën prej **24,990,890** (njëzetë e katërmilion e nëntëqind e nëntëdhjetëmijë e tetëqind e nëntëdhjetë) **lekë pa TVSH.**

**4. Operatori Ekonomik “SHENDELLI” shpk**, me NIPT K07924803N, ka paraqitur ofertën ekonomike në shumën prej **30,946,434** (tridhjetëmilion e nëntëqind e dyzetë e gjashtëmijë e katërqind e tridhjetë e katër) **lekë pa TVSH**.

**Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm përkatësisht për arsyet:**

**1. Operatori Ekonomik “ARDMIR” shpk**, me NIPT K82509006P, me ofertë ekonomike në shumën prej 29,970,387 (njëzetë e nëntëmilion e nëntëqind e shtatëdhjetëmijë e treqind e tetëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH, **nuk është në përputhje me të gjitha kërkesat për kualifikim** të përcaktuara në dokumentat e tenderit **dhe Oferta e tij nuk është e vlefshme** për të kaluar në fazën e krahasimit dhe vlerësimit të ofertave, për të përcaktuar ofertën më të mirë, sipas kriterit “oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim”, pasi ka këto mangësi në dokumentacionin e paraqitur:

- Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar në pikën “3.1.”, të kapacitetit teknik, te Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, në Shtojcën 7, të Dokumentave Standarte të Tenderit, lidhur me kontratat e mëparshme të realizuara, pasi kontrata e paraqitur nr.3648/6 prot, datë 13.06.2018, me vlerë 9,748,453 lekë pa TVSH e lidhur me Bashkia Fier, është realizuar jashtë afatit të kërkuar, pra, nuk është realizuar gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës (shpallja e njoftimit të kontratës objekt prokurimi datë 05.05.2022). Për këtë kontratë, nuk është paraqitur as vërtetimi për realizimin e suksesshëm të kontratës nga enti publik, si dhe vlera e saj është më e vogël se 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet. E njëjta situatë është edhe për kontratën e paraqitur nr.220/9 prot, datë 16.04.2018, me vlerë 1,706,083 lekë pa TVSH e lidhur me Drejtorinë e Ujitjes dhe Kullimit Fier. Po ashtu, kontrata në sektorin privat me subjektin “ZDRAVO” shpk nuk merret në konsideratë, pasi nuk janë paraqitur fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Rrjedhimisht nga OE “ARDMIR” shpk, nuk plotësohet kjo kërkesë.

- Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar në pikën “3.5.”, të kapacitetit teknik, te Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, në Shtojcën 7, të Dokumentave Standarte të Tenderit, pasi referuar Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të dorëzuar nga OE “ARDMIR” shpk, në rubrikën “B. DEKLARATË Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme”, rezulton se nuk figurojnë të listuar 4 (katër) eskavatorë të kërkuar.

Rrjedhimisht nga OE “ARDMIR” shpk, nuk plotësohet kjo kërkesë.

**\* \* \***

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin Ekonomik: **“ELMAZAJ KONSTRUKSION” shpk**, me NIPT L33229401T, me adresë PORTËZ, Fier, zona kadastrale 3031, nr.Pasurie 307/39, se oferta e paraqitur, me vlerë totale prej **24,990,890** (njëzetë e katërmilion e nëntëqind e nëntëdhjetëmijë e tetëqind e nëntëdhjetë) **lekë pa TVSH**, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109, të Ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**

**Qerim Ismailaj**